Square Software SH.P.K.
Rruga Millosh Shutku, Nd. 14, H. 3, Ap. 17, Njësia Administrative Nr. 1, Njësia Bashkiake Nr. 1, 1004
Tiranë, Albania
NUIS M51418039H | info@square.al | square.al

SQUARE SOFTWARE SHPK

Marrëveshje Konfidencialiteti dhe Moszbulimi

NDA e ndërsjellë

Nr. Prot.
Datë

Ky dokument plotësohet me të dhënat e palës bashkëpunuese, nënshkruhet në çdo faqe dhe dorëzohet pranë SQUARE SOFTWARE SHPK përpara fillimit të çdo bashkëpunimi.

Në këtë marrëveshje:

- "Kodi Civil" është Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar;
- "Ligji për Shoqëritë Tregtare" është Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- "Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave" është Ligji nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- "Komisioneri" është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP);
- "Marrëveshja" është kjo Marrëveshje Konfidencialiteti dhe Moszbulimi.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA I: SQUARE SOFTWARE SHPK

Emri i Subjektit	SQUARE SOFTWARE SHPK
Forma ligjore	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK)
NUIS	M51418039H
Selia	Rruga Millosh Shutku, Nd. 14, H. 3, Ap. 17, Njësia Administrative Nr. 1, Njësia Bashkiake Nr. 1, 1004 Tiranë, Shqipëri
Përfaqësuar nga	Edmirjano Preçi, Administrator
E-mail	info@square.al | Web: www.square.al | Tel: +355 69 666 6614

(më poshtë referuar si "Square Software")

PALA II: PALA BASHKËPUNUESE

Emri i Subjektit / Emër Mbiemër	
Forma ligjore	
NUIS / Nr. Personal i ID	
Adresa	
Përfaqësuar nga	
Funksioni	
E-mail	
Tel	

(më poshtë referuar si "Pala Bashkëpunuese")

Square Software dhe Pala Bashkëpunuese referohen së bashku si "Palët" dhe secila veç e veç si "Pala".

PREAMBULË

Duke qenë se Palët synojnë të hyjnë në diskutime, negociata dhe/ose një marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e zhvillimit të software-it, shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe/ose shërbimeve të tjera që përfshihen në objektin e veprimtarisë së Square Software;

Duke qenë se në kuadër të këtij bashkëpunimi secila Palë mund t'i japë ose t'i vërë në dispozicion Palës tjetër informacione me natyrë konfidenciale, përfshirë sekrete tregtare, të dhëna teknike, tregtare dhe/ose të dhëna personale;

Duke pasur parasysh Kodin Civil, Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave dhe legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

Palët, me vullnet të lirë e të plotë, bien dakord si më poshtë:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1
OBJEKTI I MARRËVESHJES

1.1 Kjo Marrëveshje përcakton kushtet dhe detyrimet e Palëve në lidhje me trajtimin, ruajtjen dhe moszbulimin e Informacionit Konfidencial që shkëmbehet ndërmjet tyre, përpara, gjatë dhe pas çdo bashkëpunimi të mundshëm (më poshtë "Qëllimi").

1.2 Kjo Marrëveshje ka natyrë të ndërsjellë: detyrimet e konfidencialitetit zbatohen për secilën Palë që merr Informacion Konfidencial nga Pala tjetër.

1.3 Kjo Marrëveshje nuk krijon asnjë detyrim për Palët për të lidhur kontrata të mëtejshme, për të kryer investime apo për të vazhduar negociatat, dhe nuk përbën shoqëri të thjeshtë, agjenci, përfaqësim apo marrëdhënie punësimi ndërmjet Palëve.

NENI 2
PËRKUFIZIME

2.1 "Informacion Konfidencial" është çdo informacion, i çfarëdo forme apo natyre (me shkrim, me gojë, në formë elektronike, vizuale ose të prekshme), që një Palë ("Pala Zbuluese") i jep ose i vë në dispozicion Palës tjetër ("Pala Marrëse") në kuadër të Qëllimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- kod burimor dhe kod objekt, arkitekturë software-i, algoritme, modele të inteligjencës artificiale, baza të dhënash, dokumentacion teknik dhe specifikime;
- plane biznesi, strategji tregtare e marketingu, analiza, raporte, çmime, oferta, kushte kontraktore dhe të dhëna financiare;
- lista klientësh, furnitorësh, partnerësh dhe kontakte tregtare;
- know-how, sekrete tregtare, ide, koncepte, prototipe dhe projekte në zhvillim;
- të dhëna personale sipas përkufizimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave;
- vetë ekzistencën dhe përmbajtjen e negociatave dhe të kësaj Marrëveshjeje.

2.2 "Të dhëna personale" është çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm, sipas përkufizimit të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave.

2.3 "Përpunim" është çdo veprim ose bashkësi veprimesh që kryhet mbi të dhënat personale, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja, konsultimi, përdorimi, transmetimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi.

2.4 "Përfaqësues" janë punonjësit, administratorët, ortakët, bashkëpunëtorët, nënkontraktorët dhe këshilltarët profesionalë të një Pale, të cilët kanë nevojë të njihen me Informacionin Konfidencial për realizimin e Qëllimit.

NENI 3

FUSHA E ZBATIMIT

3.1 Kjo Marrëveshje zbatohet për çdo Informacion Konfidencial të shkëmbyer ndërmjet Palëve, pavarësisht nëse ai është shënuar shprehimisht si "konfidencial" apo jo, kur nga natyra e informacionit ose rrethanat e zbulimit rezulton në mënyrë të arsyeshme se ai është konfidencial.

3.2 Marrëveshja mbulon edhe informacionin e shkëmbyer ndërmjet Palëve përpara datës së nënshkrimit të saj, në kuadër të të njëjtit Qëllim.

KREU II
DETYRIMET E KONFIDENCIALITETIT

NENI 4

DETYRIMET E PALËS MARRËSE

4.1 Pala Marrëse detyrohet të:

a. ruajë Informacionin Konfidencial me kujdesin e duhur profesional dhe, në çdo rast, me jo më pak kujdes sesa ruan informacionin e vet konfidencial;
b. përdorë Informacionin Konfidencial vetëm për realizimin e Qëllimit dhe për asnjë qëllim tjetër;
c. mos e zbulojë, publikojë, shpërndajë, kopjojë, riprodhojë apo vërë në dispozicion të palëve të treta Informacionin Konfidencial, pa miratimin paraprak me shkrim të Palës Zbuluese;
d. ia zbulojë Informacionin Konfidencial vetëm atyre Përfaqësuesve të vet që kanë nevojë të njihen me të për realizimin e Qëllimit, duke siguruar që këta Përfaqësues të jenë të detyruar me detyrime konfidencialiteti jo më pak të rrepta se ato të kësaj Marrëveshjeje; Pala Marrëse përgjigjet për çdo shkelje të kryer nga Përfaqësuesit e saj;
e. mos e përdorë Informacionin Konfidencial për të zhvilluar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, produkte a shërbime konkurruese, për përfitim të vetin apo të palëve të treta;
f. mos kryejë dekompilim, inxhinieri të kundërt (reverse engineering) apo çmontim të software-it, prototipeve apo materialeve të vëna në dispozicion, përveçse kur lejohet shprehimisht nga ligji;
g. njoftojë menjëherë me shkrim Palën Zbuluese për çdo humbje, akses të paautorizuar, përdorim apo zbulim të paautorizuar të Informacionit Konfidencial për të cilin merr dijeni, dhe të bashkëpunojë për kufizimin e pasojave.

NENI 5

PËRJASHTIMET

5.1 Detyrimet e kësaj Marrëveshjeje nuk zbatohen për informacionin për të cilin Pala Marrëse provon me dokumente se:

a. ishte ose është bërë publik pa shkelje të kësaj Marrëveshjeje;
b. ishte në zotërim të ligjshëm të Palës Marrëse përpara marrjes së tij nga Pala Zbuluese, pa detyrim konfidencialiteti;
c. i është dhënë asaj në mënyrë të ligjshme nga një palë e tretë që nuk kishte detyrim konfidencialiteti ndaj Palës Zbuluese;
d. është zhvilluar në mënyrë të pavarur nga Pala Marrëse, pa përdorur Informacionin Konfidencial të Palës Zbuluese.

NENI 6

ZBULIMI I DETYRUAR ME LIGJ

6.1 Nëse Palës Marrëse i kërkohet të zbulojë Informacion Konfidencial në zbatim të një detyrimi ligjor, urdhri gjyqësor ose kërkese të një autoriteti publik kompetent, ajo, në masën e lejuar nga ligji: (a) njofton menjëherë me shkrim Palën Zbuluese përpara zbulimit, në mënyrë që kjo e fundit të ketë mundësi të kërkojë masa mbrojtëse; dhe (b) zbulon vetëm atë pjesë të Informacionit Konfidencial që kërkohet në mënyrë të detyrueshme.

KREU III
MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

NENI 7
PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

7.1 Kur, në kuadër të Qëllimit, një Palë përpunon të dhëna personale të vëna në dispozicion nga Pala tjetër, ajo detyrohet të veprojë në përputhje të plotë me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe udhëzimet e Komisionerit.

7.2 Në veçanti, Pala që përpunon të dhëna personale detyrohet të:

a. përpunojë të dhënat personale në mënyrë të ligjshme, të ndershme dhe transparente, vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë e legjitime, dhe në masën minimale të nevojshme;
b. mos i përpunojë të dhënat personale për qëllime të tjera, të papajtueshme me Qëllimin, dhe të mos i transferojë ato te palë të treta apo jashtë Republikës së Shqipërisë pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër dhe pa u përmbushur kushtet ligjore për transferim;
c. sigurojë që personat e autorizuar për përpunimin e të dhënave të kenë marrë përsipër detyrimin e konfidencialitetit;
d. ndihmojë Palën tjetër në përmbushjen e detyrimeve për t'iu përgjigjur kërkesave të subjekteve të të dhënave për ushtrimin e të drejtave të tyre (aksesi, korrigjimi, fshirja, kufizimi, kundërshtimi dhe portabiliteti);
e. njoftojë Palën tjetër pa vonesë të panevojshme, dhe në çdo rast jo më vonë se 24 orë nga marrja dijeni, për çdo shkelje të sigurisë së të dhënave personale, në mënyrë që kjo e fundit të përmbushë, kur është rasti, detyrimin e njoftimit të Komisionerit brenda 72 orëve;
f. fshijë ose kthejë, sipas zgjedhjes së Palës tjetër, të gjitha të dhënat personale pas përfundimit të Qëllimit ose të kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur ruajtja e tyre kërkohet nga ligji.

7.3 Nëse bashkëpunimi ndërmjet Palëve përfshin përpunim të strukturuar e të vazhdueshëm të të dhënave personale në emër dhe për llogari të njërës Palë, Palët do të lidhin një marrëveshje të posaçme përpunimi të dhënash (kontrollues/përpunues) sipas kërkesave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave, e cila plotëson por nuk zëvendëson këtë Marrëveshje.

NENI 8
MASAT E SIGURISË

8.1 Secila Palë zbaton masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm me rrezikun, duke përfshirë, sipas rastit:

a. kontrollin dhe kufizimin e aksesit në Informacionin Konfidencial dhe në të dhënat personale vetëm për personat e autorizuar;
b. enkriptimin dhe/ose pseudonimizimin e të dhënave gjatë transmetimit dhe ruajtjes, sipas rastit;
c. ruajtjen e sigurt të dokumenteve fizike dhe të pajisjeve që përmbajnë Informacion Konfidencial;
d. garantimin e konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit;

e. testimin dhe vlerësimin periodik të efektivitetit të masave të sigurisë.

KREU IV
PRONËSIA DHE KTHIMI I INFORMACIONIT

NENI 9
PRONËSIA E INFORMACIONIT DHE E TË DREJTAVE

9.1 Informacioni Konfidencial mbetet pronë ekskluzive e Palës Zbuluese. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk interpretohet si dhënie licence, transferim pronësie apo dhënie e ndonjë të drejte tjetër mbi Informacionin Konfidencial, mbi të drejtat e pronësisë intelektuale a industriale, markat, patentat, të drejtat e autorit apo sekretet tregtare të Palës Zbuluese.

9.2 Çdo material, analizë, dokument apo produkt që përmban ose bazohet në Informacionin Konfidencial të Palës Zbuluese trajtohet gjithashtu si Informacion Konfidencial i asaj Pale.

NENI 10
KTHIMI OSE ASGJËSIMI I INFORMACIONIT

10.1 Me përfundimin e Qëllimit, me përfundimin e kësaj Marrëveshjeje ose me kërkesën e parë me shkrim të Palës Zbuluese, Pala Marrëse, brenda 10 (dhjetë) ditëve: (a) i kthen Palës Zbuluese të gjithë Informacionin Konfidencial dhe çdo kopje të tij; ose (b) e asgjëson atë në mënyrë të sigurt dhe të pakthyeshme, duke e konfirmuar me shkrim asgjësimin.

10.2 Pala Marrëse mund të ruajë një kopje vetëm në masën që kjo kërkohet nga një detyrim ligjor, duke vazhduar të zbatojë për të detyrimet e kësaj Marrëveshjeje.

KREU V
KOHËZGJATJA DHE PËRGJEGJËSIA

NENI 11
KOHËZGJATJA

11.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët dhe qëndron në fuqi për një afat 5 (pesë) vjeçar, përveçse kur Palët përcaktojnë ndryshe me shkrim.

11.2 Detyrimet e konfidencialitetit vazhdojnë të zbatohen edhe për 5 (pesë) vjet pas përfundimit të Marrëveshjes për çfarëdo shkaku. Për sekretet tregtare dhe për të dhënat personale, detyrimet vazhdojnë pa afat, për aq kohë sa informacioni ruan natyrën e sekretit tregtar, përkatësisht për aq kohë sa e kërkon Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave.

NENI 12
SHKELJA DHE DËMSHPËRBLIMI

12.1 Palët pranojnë se shkelja e kësaj Marrëveshjeje mund t'i shkaktojë Palës Zbuluese dëme të konsiderueshme e të vështira për t'u llogaritur, dhe se dëmshpërblimi në të holla mund të mos jetë i mjaftueshëm. Për këtë arsye, Pala Zbuluese ka të drejtë të kërkojë pranë gjykatës kompetente edhe marrjen e masave të sigurimit të padisë dhe ndalimin e menjëhershëm të shkeljes, krahas çdo mjeti tjetër ligjor.

12.2 Në rast shkeljeje të detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje, Pala shkelëse detyrohet t'i paguajë Palës tjetër një penalitet kontraktor prej _____ Lekë për çdo shkelje, pa cenuar të drejtën e Palës së dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblimin e plotë të dëmit faktik dhe të fitimit të munguar, sipas dispozitave të Kodit Civil, në masën që dëmi tejkalon penalitetin.

12.3 Shkelja e detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale mund të sjellë edhe përgjegjësi administrative sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe/ose përgjegjësi penale sipas legjislacionit në fuqi, të cilat nuk përjashtohen nga kjo Marrëveshje.

NENI 13

MOSJOSHJA E PERSONELIT DHE E KLIENTËVE

13.1 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje dhe për 12 (dymbëdhjetë) muaj pas përfundimit të saj, asnjëra Palë nuk do të nxisë a joshë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, punonjësit, bashkëpunëtorët apo klientët e Palës tjetër, me të cilët ka rënë në kontakt për shkak të Qëllimit, për të ndërprerë marrëdhëniet e tyre me Palën tjetër, pa miratimin paraprak me shkrim të kësaj të fundit.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 14

NJOFTIMET

14.1 Çdo njoftim në kuadër të kësaj Marrëveshjeje bëhet me shkrim dhe dërgohet në adresat postare ose elektronike të Palëve të përcaktuara në krye të kësaj Marrëveshjeje. Njoftimi me e-mail konsiderohet i marrë ditën e parë të punës pas dërgimit, me kusht që të mos jetë kthyer njoftim automatik moslëvrimi.

NENI 15

LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

15.1 Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

15.2 Çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo Marrëveshje ose në lidhje me të do të zgjidhet fillimisht me mirëkuptim ndërmjet Palëve. Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve, ajo i nënshtrohet për zgjidhje Gjykatës kompetente të Tiranës.

NENI 16

DISPOZITA TË NDRYSHME

16.1 Kjo Marrëveshje përbën vullnetin e plotë të Palëve për objektin e saj dhe zëvendëson çdo marrëveshje a mirëkuptim të mëparshëm, me shkrim ose me gojë, për të njëjtin objekt.

16.2 Çdo ndryshim ose shtesë e kësaj Marrëveshjeje bëhet vetëm me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja Palët.

16.3 Pavlefshmëria e një dispozite të veçantë nuk sjell pavlefshmërinë e Marrëveshjes në tërësi; dispozita e pavlefshme zëvendësohet me një dispozitë të vlefshme sa më të afërt me qëllimin ekonomik e juridik të saj.

16.4 Asnjëra Palë nuk mund t'ia kalojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje një pale të tretë pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër.

16.5 Mosushtrimi ose vonesa në ushtrimin e një të drejte sipas kësaj Marrëveshjeje nuk përbën heqje dorë prej saj.

Kjo Marrëveshje u hartua dhe u nënshkrua në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën Palë, të cilat kanë të njëjtën vlerë ligjore.

Vendi: _____ Datë: _____

PALA I	**PALA II**
SQUARE SOFTWARE SHPK	PALA BASHKËPUNUESE
Edmirjano Preçi, Administrator	
_____	_____
(emri, nënshkrimi, vula)	*(emri, nënshkrimi, vula)*